

**UDHËZIM**  
**Nr.26, datë 4.9.2008**

**PËR TAKSAT KOMBËTARE**  
**I NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave

**UDHËZON:**

**1. Dispozita të përgjithshme**

1.1. Ligji “Për Taksat Kombëtare” përcakton llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, mënyrën e pagesës tek drejtoritë rajonale tatimore të taksave dhe tarifave kombëtare, transferimin e të ardhurave nga taksat tek njësitë e qeverisjes vendore, përjashtimet nga pagesat e taksave dhe tarifave kombëtare si dhe sanksionet.

Termat “taksë”, “tarifë”, “taksapagues”, “agjenti i taksave dhe tarifave” kanë kuptimin e dhënë në nenin 2 të ligjit.

1.2 Në përputhje me nenin 5 të ligjit, agjentët e taksave kombëtare përcaktohen me këtë ligj, ndërsa agjentët e tarifave në zbatim të nenit 11 të ligjit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe titullarëvetë institucioneve përkatëse.

1.2.1 Taksat dhe tarifave kombëtare vetëvlerësohen dhe vetëdeklarohen, nga agjentët e taksave dhe tarifave, kur ato mblidhen nëpërmjet tyre, apo nga vetë paguesi i tyre, individ, personi juridik apo fizik, kur ato nuk mblidhen nëpërmjet agjentit. Agjentët e taksave dhe tarifave, apo vetë individët, personat juridikë dhe fizikë pagues të tyre, në cilësinë e personit të tatueshëm, deklarojnë dhe paguajnë detyrimet për taksat dhe tarifave kombëtare sipas dispozitave të ligjit dhe të këtij udhëzimi.

Çdo person i tatueshëm, subjekt i taksës dhe tarifës kombëtare, apo çdo “agjent i taksës dhe tarifës kombëtare”, i ngarkuar nga ligji me mbledhjen e tyre, duhet të bëjnë një deklaratë për çdo muaj, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit paraardhës për të cilin bëhet deklarimi. Periudha tatimore për deklarimin dhe pagimin e taksave dhe tarifave kombëtare, është përcaktuar në ligj.

Deklarimi bëhet në përputhje me modelet e miratuara të deklaratave që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë e tij, specifikuar: Formulari i deklarimit dhe pagesës së taksave kombëtare; formulari i deklarimit dhe pagesës së tarifave kombëtare dhe formulari i deklarimit dhe pagesës së taksës së rentës minerare.

Nuk janë të detyruar të paraqesin deklaratë për taksat dhe tarifave kombëtare, ata persona, të cilëve, taksa apo tarifa kombëtare e paguar prej tyre, u është mbajtur nga agjenti i ngarkuar i taksës apo tarifës kombëtare, i cili ka më pas detyrimin për deklarimin dhe pagimin e tyre në administratën tatimore, si dhe administratë doganore për taksën e rentës minerare të paguar nga personat juridikë/fizikë në doganë për produktet minerare të eksportuara.

Çdo person i tatueshëm, subjekt i taksës dhe tarifës kombëtare, apo çdo “agjent i taksës dhe tarifës kombëtare”, i ngarkuar nga ligji me mbledhjen e tyre, duhet të paguajnë taksat dhe tarifakombëtare të deklaruar për atë periudhë tatimore (muaj), në ose para datës së detyrueshme të deklarimit.

Për pagesën me vonesë të tyre nga paguesi i taksës/tarifës kombëtare apo agjentët e taksave dhe tarifave kombëtare zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” , për agjentët e taksave dhe tarifave zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

1.2.2. Personat e tatueshëm apo agjentët të cilët kanë detyrimin për të deklaruar dhe paguar taksat dhe tarifat kombëtare, deklarojnë shumat e taksave dhe tarifave kombëtare vetëm në rrugë elektronike, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al). Deklaratat tatimore të taksave dhe tarifave kombëtare, si dhe deklarata e rentës minerare konsiderohen të dorëzuara, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar nga ana e personit të tatueshëm.

Personat e tatueshëm subjekte të taksave dhe tarifave kombëtare, si dhe agjentët e taksave dhe tarifave kombëtare, duhet të dorëzojnë deklaratat e tyre tatimore edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrimepër taksat apo tarifat kombëtare.

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i çdo periudhë tatimore nga personat e tatueshëm subjekt i taksave dhe tarifave kombëtare, apo agjentëve të taksave dhe tarifave kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

1.3. Agjentët e taksave, të cilët janë ngarkuar me mbledhjen e tyre sipas përcaktimeve në nenit 5 të ligjit, përfitojnë si komision një përqindje të caktuar të arkëtimeve nga taksat kombëtare. Përqindja e komisionit qëpërfiton secili nga agjentët e taksave kombëtare përcaktohet në Ligj.

Agjentët e tarifave kombëtare, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët përfitojnë si komision një përqindje të caktuar të arkëtimeve nga tarifat kombëtare. Përqindja e komisionit që përfiton secili nga agjentët e tarifave kombëtare përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe titullarit të institucionit përgjegjës.

Agjentët e taksave vetëllogarisin shumën që përfitojnë nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar në ligj me vlerën e arkëtimeve nga taksat për periudhën tatimore.

Agjentët e tarifave vetëllogarisin shumën që përfitojnë nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me udhëzim të përbashkët me vlerën e arkëtimeve nga tarifat për periudhën tatimore.

Agjentët e taksave dhe tarifave mbajnë drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfitojnë të llogaritur si më sipër, si dhe deklarojnë dhe paguajnë në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që ata përfitojnë.

Kriteret e përdorimit të shumave të komisioneve që përfitojnë agjentë taksave kombëtare, përcaktohen në Ligj. Shumat e përfituara të komisioneve mund të përdoren për qëllimet e mëposhtme:

- a. për shpërblimin e punonjësve në formën e vështirësisë në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë problem;
- b. për pagesën e punonjësve të rinj, për rastet kur është e nevojshme të merren punonjës të rinj, për përballimin e mbledhjes së taksave dhe tarifave kombëtare;
- c. për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve të tjera për vjeljen e taksave dhe tarifave kombëtare.

Të ardhurat e përfituara në formën e komisioneve nga agjentët e mbledhjes së tarifave kombëtare, përdoren nga këta agjentë sipas nevojave të tyre.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

## **2. Dispozita të veçanta**

Sipas llojit të taksave, kemi këto lloje taksash:

### **2.1 Taksat portuale**

Taksat portuale paguhen nga anijet shqiptare ose të huaja sa herë prekin portet e Republikës së Shqipërisë. Masa e kësaj takse është 1 euro. Taksat portuale paguhen me mbërritjen e anijes në port, dhe janë të vlefshme për të gjithë kohën që anija qëndron në port. Ngarkohen me vjeljen e këtyre taksave kapitaneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare shtetërore ose private.

Në kuptimin e ligjit, nëse anija për kryerjen e veprimeve të saj do të prekë edhe një port tjetër shqiptar, paguan vetëm në portin e parë. Pra, nëse një anije mbërrin në Durrës dhe shkarkon një pjesë të mallit dhe në të njëjtin rejs shkarkon pjesën tjetër në Shëngjin, atëherë kjo anije paguan vetëm në portin e parë. Në qoftë se një anije që vjen nga një port i huaj shkarkon në portin e Durrësit ku paguan taksat portuale dhe ngarkon në këtë port një mall të ri, të cilin e shkarkon në një port tjetër shqiptar si p.sh. në Vlorë, atëherë kjo anije do të paguajë taksat portuale edhe në portin e Vlorës.

Taksat portuale paguhen në secilin port të Shqipërisë, pavarësisht nëse anija mbërrin nga jashtë ose nga një port tjetër i shtetit shqiptar. Anije të subjekteve shqiptare do të konsiderohen anijet që janë në pronësi të vet dhe anijet e marra me qira.

Kapiteneria e porteve si agjente apo agjensitë detare shtetërore ose private të caktuara prej saj për mbledhjen e taksës portuale, detyrohen të deklarojnë dhe të bëjnë pagesën në administratën tatimore të taksës portuale të mbledhur, në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

### **2.2. Taksa e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin**

Taksa e qarkullimit për benzinën zbatohet mbi produktet sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59, dhe për gazoilin sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47;

2710 19 48. Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin caktohet në masën 27 lekë/litër për benzinën dhe 27 lekë/litër për gazoilin. Kjo taksë zbatohet si për benzinën dhe gazoilin e importuar, ashtu edhe për benzinën dhe gazoilin e prodhuar në vend.

Gjithashtu, taksa e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin zbatohet edhe për benzinën ose gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit sipas kodeve tarifore të NKM-së 27102011 deri në kodin 27102019, 27102090, si dhe klasifikimin në nënkreun 382600. (Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

Për benzinën dhe gazoilin e importuar, importuesi e paguan taksën e qarkullimit pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e zhdoganimit, në momentin e kryerjes së këtyre procedurave. Deklarimi dhe pagesa e taksës së qarkullimit në administratën tatimore, bëhet nga administrata doganore si agjente e përcaktuar nga ligji për mbledhjen e kësaj takse, në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt. 16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

Kjo taksë paguhet për sasinë e benzinës dhe të gazoilit të importuar ose të prodhuar në vend, me përjashtim të sasisë së benzinës dhe të gazoilit të prodhuar në vend, por të eksportuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Subjektet prodhuese dërgojnë informacion pranë DPT-së, brenda datës 15 të muajit pasardhës, për të cilin bëhet deklarimi dhe pagesa e taksës, të dhëna mbi sasinë e gazoilit dhe benzinës të prodhuar, sasinë e eksportuar, si dhe sasinë për të cilat paguhet taksa.

Për efekt të deklarimit dhe pagesës së taksës së qarkullimit për benzinën dhe gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit dhe që përdoret në sektorin e transportit, masa e përbërësve “BIO”, e përjashtuar nga llogaritja e kësaj takse, nuk kalon nivelin 5 % të sasisë totale të biokarburantit. (Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

### 2.3. SHFUQIZOHET

(Ndryshuar me udhëzim nr.25, dt. 19.07. 2010, botuar ne Fl.Z. Nr. 94. dt. 22 korrik 2010).

### 2.3. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit:

2.3.1 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit është taksë vjetore për çdo vit kalendarik nga 1 janari deri më 31 dhjetori të vitit përkatës, për të cilën llogaritet dhe paguhet dhe ka vlefshmëri 365 ditë, pavarësisht nga momenti në të cilën ajo paguhet.

(Zëvendësuar me Udhëzimin Nr. 8, datë 14.02.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 25, datë 28.02.2020)

Kjo taksë caktohet sipas formulës:

Cilindrata në cm<sup>3</sup> x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.

Taksa fikse për llojin e karburantit është 12.5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. “Viti i vjetërsisë” është diferenca ndërmjet vitit, kur mjetit i lind detyrimi për të kryer pagesën e taksës me vitin e prodhimit. Koeficientët sipas vjetërsisë për llogaritjen e taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

Motomjete, autovetura, automjete për transport të përzier		Të gjitha llojet e tjera		Autobusët	
Mosha e Mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e Mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e Mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit
1	0,00	1	0,00	1	0,00
2	0,00	2	0,00	2	0,00
3	0,00	3	0,00	3	0,00
4	0,18	4	0,20	4	0,07
5	0,19	5	0,22	5	0,08
6	0,20	6	0,24	6	0,09
7	0,21	7	0,26	7	0,10
8	0,22	8	0,28	8	0,11
9	0,23	9	0,30	9	0,12
10	0,24	10	0,32	10	0,13
11	0,28	11	0,34	11	0,14
12	0,32	12	0,36	12	0,15
13	0,36	13	0,38	13	0,16
14	0,40	14	0,40	14	0,17
15	0,44	15	0,42	15	0,20
16	0,48	16	0,44	16	0,23
17	0,52	17	0,46	17	0,26
18	0,56	18	0,48	18	0,29
19	0,60	19	0,50	19	0,32
20	0,64	20	0,52	20	0,35
21	0,68	21	0,54	21	0,38
22	0,70	22	0,56	22	0,40
23	0,72	23	0,58	23	0,42
24	0,74	24	0,60	24	0,44

Shënim. Pas vitit të 24-t të përdorimit, për autobusët koeficienti rritet me 0,03 dhe për të gjitha mjetet e tjera rritet me 0,00. Për motomjete, autoveturat, automjetet për transport të përzier rritet me 0,04.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si agjente e përcaktuar nga ligji për mbledhjen e kësaj takse, deklarohet dhe paguan taksën e mjeteve të përdorura të transportit, në administratën tatimore, në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi.

DPSHTRR mban drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfiton të llogaritur në përputhje me këtë udhëzim. DPSHTRR llogarit dhe transferon për llogari të njësive të qeverisjes vendore shumën e të ardhurave që ju takojnë këtyre njësive nga taksa e mbledhur, si dhe deklarojnë dhe paguajnë në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që ata përfitojnë si dhe vlera e transferuar te njësitet e qeverisjes vendore.

Shënim. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. Detyrimi i taksës paguhet për vitin kalendarik (nga 1 janari deri më 31 dhjetor) për të cilin ka lindur detyrimi. Taksa e paguar në

vitin aktual, pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet, ka vlefshmëri 365 ditë.

Shëmbull: Pronari i mjetit paraqitet me datë 11.2.2019 për të paguar taksën e vitit 2019, pra detyrimin e taksës për periudhën nga 1.1.2019 deri më 31.12.2019. Afati i vlefshmërisë së kësaj takes është deri me 11.2.2020

Pagesa e taksës bëhet brenda afatit të vlefshmërisë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre kryhet brenda periudhës së vlefshmërisë 365-ditore të taksës vjetore të mjeteve të përdorura.

Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë nga dita e fundit e vlefshmërisë. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Shëmbull:

“Mjeti me cilindratë 2993 cm<sup>3</sup>, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2019 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 20.5.2019, në vlerën 17,958 lekë me afat vlefshmërie deri më 19.5.2020. Më datën 20.5.2020, pronari i mjetit paguan detyrimet për taksat e vitit 2020 dhe pajiset me vërtetim/konfirmim për kryerjen e kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit”.

Shëmbull:

Mjeti me cilindratë 2993 cm<sup>3</sup>, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2019 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 20.12.2019, në vlerën 17,958 lekë me afat vlefshmërie deri me 19.12.2020. Më datën 20.1.2020, pronari i mjetit paraqitet për kryerjen e kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

Duke qenë se kontrolli teknik i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre kryhet brenda periudhës së vlefshmërisë 365-ditore të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, konkretisht mjeti është brenda afatit të vlefshmërisë që është data 20.12.2020, pronari i mjetit pajiset me vërtetim/konfirmim për kryerjen e kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetin detyrimi për taksën e vitit 2020 ka lindur nga data 1.1.2020, por pronari afatin për ta paguar taksën e këtij viti e ka deri më datën 19.12.2020.

Shëmbull:

Mjeti me cilindratë 2993 cm<sup>3</sup>, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2018 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 22.9.2018, në vlerën 16,462 lekë me afat vlefshmërie deri me 22.9.2019. Më datën 20.1.2020, pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksat e vitit 2019 për mjetin dhe ka lindur detyrimi i taksave edhe për vitin aktual 2020. Llogariten dhe paguhen taksat e vitit 2019 në vlerën 17,958 lekë, por duke qenë se i ka kaluar afati i vlefshmërisë prej 120 ditësh kalendarike duhet të paguajë gjobë për pagesë të vonuar në shumën 1,293 lekë ( $17,958 \text{ lekë} \times 120 \text{ ditë} \times 0.06\% = 1,293 \text{ lekë}$ ). Në total detyrimet e TVMP-së për vitin 2019 janë në shumën 19,251 lekë.

Duke qenë se pronari i mjetit është paraqitur më datë 20.1.2020, vlefshmëria e TVMP-së për vitin në vazhdim llogaritet nga data 1.1.2020. Për këtë arsye, përveç taksës së vitit 2019, pronari i mjetit detyrohet të paguajë edhe detyrimin e TVMP-së për vitin 2020, në shumën 19,455 lekë dhe gjobë për pagesë të vonuar prej 233 lekë ( $19,455 \times 20 \text{ ditë} \times 0.06\%$ ). Në total vlera e taksave për vitin 2020 që duhet të paguajë është 19,688 lekë, me afat vlefshmërie deri më 20.1.2021.



Të ardhurat nga TVMP-ja, për çdo rast mbliidhen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, dhe shpërndahen sipas procedurave të përcaktuara.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën ndarjen e të ardhurave nga TVMP-ja për secilën njësi të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit sipas regjistrimit të gjendjes civile ose adresës së ushtrimit të aktivitetit sipas adresës në QKB, sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga shuma mujore e arkëtimeve nga TVMP-ja, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5(pesë)% të totalit mujor të arkëtimeve, 25 (njëzet e pesë)% e diferencës (25% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) të arkëtimeve e derdhin në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore. Pjesa tjetër e mbetur prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) % (75% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) paguhet për llogari të drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar DPSHTRR-ja (Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj) brenda datës 15 të muajit pasardhës.

Rakordimi i pagesës së TVMP-së ndërmjet strukturave të DPSHTRR-së me organet tatimore të qeverisjes qendrore dhe vendore bëhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Llogaritja e taksës bëhet nga sistemi informatik i DPSHTRR-së, pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë.

Ky dokument prodhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 8, pika 3, shkronja “c”, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Fatura e taksës duhet të përmbajë elemente sigurie, për të shmangur falsifikimin e saj. (Zëvendësuar me Udhëzimin Nr. 8, datë 14.02.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 25, datë 28.02.2020) Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike, forma dhe përmbajtja e të cilit janë sipas formularit nr. 2 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Këto drejtori, brenda datës 31 janar të çdo viti, dërgojnë në drejtoritë rajonale të tatimeve dhe në strukturat e Ministrisë së Brendshme listën e mjeteve që nuk kanë paguar taksën për vitin paraardhës, si dhe listën e mjeteve të regjistruara. Personat fizikë apo juridikë, pronarë të këtyre mjeteve, në këto lista do të trajtohen si debitorë dhe nga ana e DPSHTRR-së dhe ndaj tyre do të fillojë të zbatohen masat shtrënguese.

Në rastet e tjetërsimit të mjetit, zyrat noteriale përpara se të kryejnë procedurat e nevojshme ligjore për shitjen e tij, i kërkojnë shitësit të mjetit vërtetim nga DPSHTRR-ja nëpërmjet drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor që mjeti nuk është debitor i taksës vjetore të mjeteve të përdorura të transportit apo nuk është i bllokuar nga organet kompetente të përcaktuara me ligj.

~~Drejtoritë rajonale tatimore që të lëshojnë vërtetim “Për shlyerjen e detyrimeve tatimore” për çdo tatimpagues duhet të kërkojnë më parë vërtetim nga drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor për shlyerjen e “Taksës vjetore të mjeteve të përdorura”, të mjeteve në pronësi të tatimpaguesit~~

Në rastet e mjeteve, të cilat ndërrojnë pronësinë, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së nuk procedojnë me regjistrimin e pronësisë së mjetit në rast se për atë mjet nuk janë paguar taksat respektive.

Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë taksën vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP) në raport me kohën e hyrjes në qarkullim në territorin e Shqipërisë. Në rast se mjeti regjistrohet në muajin janar, TVMP-ja paguhet e plotë, ndërsa për periudhën në vazhdim në raport me muajt e hyrjes në qarkullim, pavarësisht datës së muajit. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, por që në momentin e targimit kërkohej të bëhet njëkohësisht edhe procedura e regjistrimit të përkohshëm të tyre, detyrimet

për TVMP llogariten dhe paguhen për muajin në të cilin mjeti do të regjistrohet, ndërkohë që bëhet edhe procedura e çregjistrimit të tij, duke dorëzuar targat dhe lejen e qarkullimi

Për mjetet që dalin përfundimisht nga qarkullimi, në momentin e paraqitjes së qytetarit për çregjistrimin e përhershëm, llogaritja e vlerës së taksës do të jetë e barabartë në raport me periudhën, që mjeti ka qenë në qarkullim.

Pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 120/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, datë 18.4.2013, të gjithë pronarët e mjeteve që nuk kanë paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura, pavarësisht kur e kanë pasur datën e pagesës së taksës, paguajnë sipas këtij ligji.

Në rast se pronari i mjetit pagesën e taksës vjetore të mjetit të përdorur e bën brenda datës 30 qershor 2013, përveç të drejtës së pagimit të vetëm gjysmës së detyrimit të përlllogaritur para hyrjes në fuqi të ligjit, përjashtohet edhe nga penalitetet për vonesë në pagesën e taksave. Për të gjitha pagesat e vonuara që kryhen pas datës 30 qershor 2013, llogarit penalitetet përkatëse. DPSHTRR-ja merr të gjitha masat që të fillojë aplikimin e tyre në sistem nga 1 janari 2014.

P.sh., pronari i një mjeti me cilindrata 1900 cm<sup>3</sup>, me naftë dhe vit prodhimi 2001, për vitin 2013 duhet ta paguante taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 15.2.2013, sipas përlllogaritjeve për vlerën 15.200 lekë:

Rasti a) Nëse paraqitet për pagesë më 20 qershor 2013, paguan 7.600 lekë taksë dhe nuk paguan penalitete.

Rasti b) Nëse paraqitet për pagesë më 1.7.2013, paguan 7.600 lekë taksë dhe i përlllogaritet 25% gjobë mbi shumën e taksës që ka paguar (6 muaj vonesë për pagesën e TVMP-së, por jo më shumë se 25%), pra në vlerën 1.900 lekë.

### 2.3.3.SHFUQIZOHET-

(Ndryshuar me udhëzim nr.25, dt. 19.07. 2010, botuar ne Fl.Z. Nr. 94, dt. 22 korrik 2010).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 8/1, dt. 17.5.2013, botuar ne Fl. Z. Nr. 89, dt. 27 maj 2013).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne FZ. nr. 193, datë 22.12.2014.)

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 25 datë 5.10.2015, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 9 tetor 2015).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 14, datë 30.04.2018, botuar ne FZ Nr.65, datë 7 maj 2018).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

(SHFUQIZOHET me Udhëzim Nr. 6 datë 20.04.2016, botuar në FZ.nr. 70, datë 25.04.2016).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 9, date 20.02.2019, botuar ne FZ nr.22 datë 25.02.2019)

**2.4. Taksa e karbonit për benzinën**(sipas kodeve të NKM-së 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59, për gazoilin, sipas kodeve tarifore 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48, për qymyrin(sipas kërërve të NKM-së 2701; 2702), për vajgurin (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27 10 19 11 deri në 27 10 19 29), për solarin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri në 2710 19 68), për mazutin (sipas kodeve të NKM-së 2710 19 62 deri në 2710 19 68) dhe për koks naftë (sipas kodeve të NKM-së 2713 11 00; 2713 12 00), si dhe për benzinën dhe gazoilin që gjenden në përmbajtjen e biokarburantit (sipas kodeve tarifore të NKM-së 27102011 deri në kodin 27102019, 27102090, si dhe klasifikimin në nënkreun 382600”. (Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

**Taksa e karbonit caktohet në masën 1.5 lekë për litër për benzinën, 3 lekë për litër për gazoilin, 3 lekë për kilogramë për qymyrin, 3 lekë për litër për solarin, 3 lekë/litri për mazutin, 3 lekë për litër për vajgurin dhe 3 lekë për kilogramë për koks naftë. Kjo taksë zbatohet si për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks naftë e importuar, ashtu edhe për ato të prodhuara në vend.**



Për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks nafte e importuar, importuesi në momentin e importimit paguan taksën e karbonit, pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e zhdoganimit, për sasinë e importuar.

Deklarimi dhe pagesa e taksës së karbonit për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koksin e naftës të importuar, në administratën tatimore, bëhet nga administrata doganore si agjente e përcaktuar nga ligji për mbledhjen e kësaj takse, në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi.

Për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks nafte e prodhuar në vend, prodhuesit llogarisin detyrimin për taksën e karbonit në bazë të sasive të prodhuara të këtyre produkteve.

Deklarimi dhe pagesa e taksës së karbonit për produktet e mësipërme të prodhuara në vend, bëhet në administratën tatimore, nga çdo tatimpagues prodhues i tyre, në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi.

Për sasitë e benzinës dhe të gazoilit të prodhuar në vend, por të eksportuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë taksa nuk paguhet. Subjektet prodhuese dërgojnë informacion pranë DPT-së, brenda datës 15 të muajit pasardhës, për të cilin bëhet deklarimi dhe pagesa e taksës, të dhëna mbi sasinë e gazoilit dhe benzinës të prodhuar, sasitë e eksportuara, si dhe sasitë për të cilat paguhet taksa.

Për efekt të deklarimit dhe pagesës të taksës së karbonit për benzinën dhe gazoilin që gjendet në përmbajtjen e biokarburantit dhe që përdoret në sektorin e transportit, masa e përbërësve “BIO” e përjashtuar nga llogaritja e kësaj takse, nuk kalon nivelin 5 % të sasisë totale të biokarburantit. (Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 9, date 20.02.2019, botuar ne FZ nr.22 datë 25.02.2019)

## 2.5. Taksa e rentës minerare

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

Taksa e rentës minerare përcaktohet në pikën 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e arkëtimit së rentës minerare dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë i licencuari, eksportuesi, për të vërtetuar çmimin e shitjes.

(Ndryshuar me udhëzim nr.25, dt. 19.07. 2010, botuar ne Fl.Z. Nr. 94. dt. 22 korrik 2010).

2.5.1 Në rastin kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin që ai ka nxjerrë nga nëntoka apo nënproduktin e prodhuar nga ky mineral, ai paguan taksën e rentës minerare në çastin e bërjes së deklaratës doganore. Pagesa mbi të dhënat e deklaratës së eksportit bëhet pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e eksportimit nga subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

a) Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin që nxjerr nga nëntoka të papërpunuar. Renta minerare përcaktohet sipas llojit të nivelit të rentës:

- kur niveli i rentës është në përqindje, shuma e rentës minerare llogaritet duke shumëzuar vlerën totale të shitjes me shumicë të mineralit që eksportohet (që është vlera e deklaruar në faturën e shitjes në bazë të çmimeve të eksportit me TVSH-0 dhe ku çmimi i shitjes në eksport është çmimi FOB Shqipëri, me përqindjen e rentës;

- kur niveli i rentës minerare është fiks për njësi, shuma e rentës llogaritet duke shumëzuar sasinë e produktit të shitur, me nivelin e rentës minerare. Një subjekt, zotërues i lejes së shfrytëzimit të mineralit të kromit, nxjerr nga nëntoka dhe eksporton të papërpunuar një sasi minerali kromi prej 5000 tonësh. Për këtë sasi minerali që eksporton ky subjekt paguan rentën vetëm në doganë dhe detyrimi për rentën llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$R = (\text{sasia e mineralit të eksportuar në ton}) \times (\text{çmimi i eksportit}) \times (\% \text{ e rentës}) = (5000 \text{ tonë}) \times (\text{çmimi i eksportit të mineralit të kromit}) \times 6\% \text{ (përcaktuar në shtojcën nr. 2, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar).}$$

b) Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, mineralin e nxjerrë nga sipërfaqja/nëntoka e përpunon më tej duke prodhuar nënprodukt të cilin e eksporton vetë.

b.1 Kur për mineralin e përfshirë në nënprodukt aplikohet nivel rente fikse për njësi, përllogaritja e rentës bëhet sipas formulës:  $R1 = \text{sasia e nënproduktit që eksportohet}) \times (\text{normativat teknologjike të mineralit të përdorur për prodhimin e nënproduktit}) \times \text{niveli fiks i rentës së mineralit të përdorur për prodhimin e nënproduktit})$

P.sh.: një subjekt, i cili zotëron leje shfrytëzimi të gurit gëlqeror (paralelisht dhe prodhues çimentoje) ka prodhuar me gurin gëlqeror që ai ka nxjerrë vetë 250 tonë çimento të bardhë, të cilën e eksporton gjithashtu vetë. Renta në këtë rast llogaritet dhe paguhet mbi vlerën e gurit gëlqeror të përdorur për prodhimin e 250 tonë çimentoje sa vijon;  $\text{renta} = 250 \text{ tonë} \times 1.6 \times 47 \text{ lekë/m}^3 = 18,800 \text{ lekë}$ ; Subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit paguan pranë degës doganore ku bëhet zhdoganim i çimentos së bardhë rentën 18 800 lekë.

b.2 Kur për mineralin e përfshirë në nënprodukt aplikohet nivel rente në përqindje (ad valorem) dallohen dy raste: - Në rastin kur për mineralin e përfshirë në nënprodukt, ekziston një çmim tregu, detyrimi për rentën llogaritet si më poshtë:

$$R2 = (\text{sasia e nënproduktit që eksportohet}) \times (\text{normativat teknologjike të mineralit të përdorur për prodhimin e nënproduktit}) \times (\text{çmimet e tregut të mineralit të përdorur për prodhimin e nënproduktit}) \times (\text{përqindja e rentës së mineralit të përdorur për prodhimin e nënproduktit}).$$
 P.sh.: një subjekt, i cili zotëron leje shfrytëzimi të mineralit të kromit është njëkohësisht edhe përpunues i këtij minerali Ai e përpunon për të prodhuar ferrokromin nga minerali i kromit me përmbajtje 40% Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>. Supozojmë se nga përpunimi i mineralit të kromit prodhohet 1 ton ferrokrom. Renta në këtë rast llogaritet dhe paguhet mbi vlerën e mineralit të kromit të përdorur për prodhimin e 1 ton ferrokromi sa vijon:  $\text{Renta} = 1 \text{ tonë} \times 2.71 \times 20\,500 \times (1/2 \times 6\%) = 1,666.65 \text{ lekë}$ ;

Subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit pagan, pranë degës doganore ku bëhet zhdoganim i ferrokromit, rentën në vlerën 1,666.65 lekë. Vlera e ferrokromit, mbi të cilën llogaritet renta (1 ton x 2.71 x 20 500) vetëdeklarohet nga subjekti. Në çdo rast për llogaritjen e detyrimit të rentës merret vlera më e lartë ndërmjet vlerës së vetëdeklaruar nga subjekti eksportues dhe vlerës referuese të zbatuar nga autoriteti doganor. Normativat dhe vlerat referuese për llogaritjen e rentës përcaktohen nga komisioni Ad-Hoc.

- Në rastin kur për mineralin e përfshirë në nënprodukt, nuk ekziston një çmim tregu, detyrimi për rentën llogaritet si më poshtë:

Për llogaritjen e rentës fillimisht përcaktohet vlera e mineralit të përfshirë në nënprodukt, në përputhje me metodikat e miratuara për këto raste nga Raporti i Komisionit Ad-Hoc sa më poshtë:

$V$  = vlera totale e shitjes së nënproduktit që eksportohet në bazë të çmimeve të eksportit x koeficientin që merr në konsideratë kostot e përpunimit dhe fitimin x normativat e mineralit për prodhimin e një njësie nënprodukti nga ku:

$V$  - është vlera e mineralit të përfshirë në nënproduktin e prodhuar, mbi të cilën llogaritet detyrimi për rentën dhe ku për mineralin nuk ka një çmim tregu.

c) Nëse subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit eksporton mineralin e nxjerrë nga miniera apo nënproduktin e prodhuar nga ky mineral, nëpërmjet një subjekti tjetër të vetëm eksportues, renta, në rastin kur është në përqindje, paguhet si nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, ashtu edhe nga eksportuesi. Renta, për produktin e shitur brenda vendit (mineral apo nënprodukt), paguhet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit pranë drejtorisë rajonale tatimore ku subjekti është i regjistruar, ndërsa nga eksportuesi, pranë organit doganor në çastin e eksportimit të mineralit apo nënproduktit të blerë nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit. Llogaritja dhe pagesa e rentës në rastin kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit i shet subjektit eksportues produktin mineral (mineralin apo nënproduktin që ai prodhon) bëhet sipas pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”.

Ky subjekt pagan rentën pranë administratës tatimore për shitjet e bëra brenda vendit të bazuar në faturat e shitjes me TVSH. Në momentin kur subjekti eksportues, eksporton mineralin që ka blerë nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit apo nënproduktin mineral, ai pagan rentën minerare vetëm për diferencën ndërmjet vlerës së rentës së përlllogaritur në bazë të çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB në Shqipëri, dhe vlerës së rentës të paguar nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit në përputhje me pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”. Në momentin e eksportit në degën doganore, në bazë të deklaratës së eksportit dhe dokumentacionit shoqërues, përlllogaritet vlera e plotë dhe shuma e rentës minerare për sasinë e mineralit apo nënproduktit që po eksportohet. Subjekti deklarues është i detyruar që në momentin e eksportimit, pranë organit doganor të vetëdeklarojë shumën e rentës minerare të paguar (pranë organeve tatimore) për sasinë e mineralit apo nënproduktit që po eksportohet, si dhe të depozitojë dokumentet përkatëse.

Shuma që do të paguhet në doganë, do të jetë diferenca ndërmjet shumës së llogaritur për vlerën e plotë të rentës dhe shumës së rentës së vetëdeklaruar si të paguar pranë organeve tatimore. Organet tatimore, në bazë të të dhënave që marrin nga organet doganore, verifikojnë saktësinë e vetëdeklarimeve të bëra nga subjektet eksportuese dhe marrin masa për rregullimin e situatës në rast konstatimi të diferencave, si dhe njoftojnë organet doganore. Në rastin kur renta është fikse për njësi, subjekti eksportues në momentin e eksportimit, pranë organit doganor deklaron sasinë e mineralit apo nënproduktit mineral që po eksportohet, si dhe depoziton dokumentet përkatëse që vërtetojnë se renta minerare për këtë sasi minerali apo nënprodukti mineral është paguar nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit pranë organeve tatimore. Taksa e rentës minerare për mineralet apo nënproduktet e eksportuara nga personat juridikë dhe fizikë që detyrohen me ligj të paguajnë këtë taksë, paguhet në organet doganore në momentin e kryerjes së procedurës së eksportit. Deklarimi nga personat fizikë dhe juridikë të rentës së paguar në doganë, në përputhje me formularin e deklarimit dhe pagesës së taksës së rentës minerale bëhet vetëm për efekt deklarativ. Dogana transferon të ardhurat e rentës minerale të eksportuar në buxhetin e shtetit. Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin mineralar është në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, “Grupi i parë (I) Mineralet metalike” që i bashkëlidhet ligjit. Në shembujt e dhënë në këtë pikë për llogaritjen e rentës për nënproduktet,% e rentës për mineralet metalore korrektohet me 1/2 e normës së rentës së përcaktuar në shtojcën nr. 2, “Grupi i parë (I) Mineralet metalike.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

2.5.2 Kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit shet për konsum final brenda vendit mineralin apo nënproduktin e prodhuar prej tij, ai llogarit taksën e rentës minerare, për të gjithë sasinë e shitur. Këta tatimpagues detyrohen të bëjnë deklaratën dhe të paguajnë rentën në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi, sipas formatit të miratuar për deklarimin dhe pagesën e taksës së rentës minerare.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

Në rastin e shitjes së mineralit të grupit të parë (I), “Mineralet metalike”, për përpunim brenda vendit, nga nxjerrësi te përpunuesi, përqindja e rentës aplikohet në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim së përcaktuar në shtojcën nr. 2, mbi vlerën (çmimin) e shitjes, e cila, për efekt të përlllogaritjes së rentës minerare, nuk mund të jetë më e vogël se çmimi i shitjes për eksport të mineralit të papërpunuar. Subjekti llogarit rentën sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”. Në çdo moment të përpilimit të faturës tatimore subjektet kanë detyrimin për të verifikuar çmimin e eksportit të publikuar për këtë qëllim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

2.5.3. Njësitë e qeverisjes vendore ku subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit zhvillon aktivitetin mineralar, brenda datës 30 të çdo muaji, sipas formularit nr. 8 bashkëlidhur si pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, bëjnë rakordimin me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe degët e doganave për rentën minerare të mbledhur prej tyre.

Një kopje të rakordimit, njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 5 të muajit pasardhës, e dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

**2.5.4.** Drejtoritë rajonale tatimore dhe degët doganore të cilat janë agjentë tatimorë, brenda datës 30 të çdo muaji dërgojnë informacion analitik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, për vlerën e rentës minerare të mbledhur, subjektin tatimor dhe njësitë e qeverisjes vendore ku kryhet aktiviteti, sipas formularit nr.9 bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij.

(Ndryshuar me Udhëzim nr.6, datë 28.2.2012 botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 21, date 20 mars 2012.)

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

**2.5.5.** Shpërndarja e të ardhurave të rentës minerare për njësitë e qeverisjes vendore. të cilat përfshihen në territorin e shoqërive (subjekteve), që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit të naftës dhe që paguajnë rentën minerare, bëhet bazuar në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij.

Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

**(Ndryshuar me Udhëzim nr.6, datë 28.2.2012 botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 21, date 20 mars 2012.**

**2.5.6.** Pjesa e të ardhurave nga renta minerale, sipas përqindjes së përcaktuar në Ligj, që u takon njërive të qeverisjes vendore (përfshirë edhe ato të naftës sipas pikës 2.5.5), shpërndahet nga strukturat përgjegjëse të buxhetit në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave njofton zyrtarisht drejtorinë rajonale të tatimeve/doganave, respektive, dhe njësinë e qeverisjes vendore, për masën e llogaritur të shpërndarjes së të ardhurave nga renta minerale. Drejtoritë Rajonale të tatimeve dhe doganave paraqesin kërkesën për transferimin e fondit në degën përkatëse të thesarit. Dega e thesarit ku ndodhet drejtoria rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon, duke përdorur metodën e transferimeve të brendshme në sistemin e informatizuar financiar të qeverisë.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

## **SHTOJCA NR.1**

### **SHPËRNDARJA E RENTËS MINERARE ME PUSHTETIN VENDOR PËR PRODUKTET E NAFTËS DHE GAZIT**

Administrata qendrore tatimore dhe administrata doganore, për rentën minerare të paguar nga subjektet e mëposhtme, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e hidrokarbureve, nga totali i rentës së paguar, **5%** e të ardhurave mujore nga kjo rentë, ndahet në % sipas komunave dhe bashkive të specifikuara si më poshtë.

1. Për shpërndarjen e **5%** të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "Bankers Petroleum



Albania Ltd." për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Patos, Marinëz, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 16.7.2004:

- Bashkia Patos 20%;
- Bashkia Roskovec 4%
- njësi administrative Mbrostar 13%;
- njësi administrative Zharrëz 20%;
- njësi administrative 30%;
- njësi administrative Portëz 7%;
- njësi administrative Ruzhdië 1%;
- njësi administrative Bubullimë 5%.

2. Për shpërndarjen e **5%** të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "Stream Oil&Gas", për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Ballsh, Hekal, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 8.8.2007:

- njësi administrative Hekal 20%;
- njësi administrative Qendër Mallakastër 80%.

3. Për shpërndarjen e **5%** të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "Stream Oil&Gas", për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Cakran-Mollaj, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 8.8.2007:

- njësi administrative Hekal 80%;
- njësi administrative Qendër Mallakastër 20%.

4. Për shpërndarjen e **5%** të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "Stream Oil&Gas", për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Gorisht-Kocul, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 8.8.2007:

- njësi administrative Vllahinë, Vlorë 100%.

5. Për shpërndarjen e **5%** të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "Stream Oil&Gas", për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit Delvinë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 8.8.2007:

- Bashkia Delvinë 100%.

6. Për shpërndarjen e **5%** të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "Sharewood International Petroleum Ltd." për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve për vendburimin e naftës Kuçovë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 19.10.2007:

- njësi administrative Kozarë 45%;
- njësi administrative Perondi 34%;
- Bashkia Kuçovë 5%;
- njësi administrative Poshnjë 13%;
- Bashkia Ura Vajguore 3%.

7. Për shpërndarjen e **5%** të rentës minerare, për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese, në kuadër të marrëveshjes hidrokarbure me kompaninë "IEC Visoka Inc." për vlerësimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e naftës Visokë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 27.1.2009:

- njësi administrative Qendër Mallakastër 45%;



- njësi administrative Rrushdie 30%;

- Bashkia Patos 25%.

8. Për shpërndarjen e **5%** të rentës minerare për prodhimin e naftës e gazit nga vendburimet ekzistuese që administrohen nga "Albpetrol" sh.a., në mbështetje të Marrëveshjes "Albpetrol", të miratuar me ligjin nr. 7853, datë 29.7.1994 "Për disa shtesa në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)":

A. Vendburimet e gazit:

1. Divjakë-Ballaj

- Bashkia Divjakë 50%;

- njësi administrative Gosë 50%.

2. Frakull

- njësi administrative Frakull 60%;

- njësi administrative Levan 40%.

3. Povelçe

- njësi administrative Dermenas 100% (Ky vendburim nuk jep prodhim);

4. Panaja

- njësi administrative Qendër (Vlorë) 100% (Ky vendburim nuk jep prodhim).

B. Vendburimet e naftës:

1. Amonice

- njësi administrative Sevaster 60%;

- njësi administrative Vllahinë 40%.

2. Drashovicë

- njësi administrative Vllahinë 100% (Ky vendburim nuk jep prodhim);

3. Rasë-Pekisht-Murriz

- njësi administrative Rasë 30%;

- njësi administrative Shezë 40%;

- njësi administrative... (Murrizi) 30%.

4. Finiq-Kranë (i abandonuar)

- njësi administrative Finiq

- njësi administrative Mesopotam

5. Rerat Bituminoze Kasnice

- njësi administrative Ruzhdie 100%.

(Ndryshuar me Udhëzim nr.6, datë 28.2.2012 botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 21, date 20 mars 2012).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

## **2.6. Taksa e akteve dhe e pullës**

Shtetasit, për çdo dokument të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile, janë të detyruar të paguajnë taksën sipas shtojcës nr.3 të ligjit. Dokumentet e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm kur kanë pullën e taksës të vulosur me vulën e gjendjes civile. Vjelja e këtyre taksave bëhet nga zyrat e gjendjes civile Vjelja e taksës për kartën e identitetit bëhet me mandatarkëtimi.

Zyrat e gjendjes civile, si agjentë të përcaktuar nga ligji, deklarojnë dhe paguajnë taksën e akteve dhe të pullës, në administratën tatimore, në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

## Pika 2.6 shfuqizohet

### 2.7. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit

Kjo taksë është vjetore dhe me vjeljen e saj ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit në ministrinë përgjegjëse për ujërat. Pagesat e kësaj takse bëhen sipas shtojcës nr.4 të ligjit. Detyrimi për pagimin e kësaj takse lind në momentin e marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit. Lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit jepen mbasi të jetë paguar taksa përkatëse.

Drejtorja e Politikave të Peshkimit dhe degët e saj, si agjente të përcaktuara nga ligji, deklarojnë dhe paguajnë taksën për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit, në administratën tatimore, në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

### 2.8 Taksa e materialeve/artikujve plastikë, lëndëve të para të importuara për prodhimin e tyre dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi.

2.8.1 Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike që importohen dhe bëjnë pjesë në kapitullin 39 të NKM-së, është 35 lekë/kg. Nuk e paguajnë këtë taksë 35 lekë/kg, lëndët e para në forma primare që importohen sipas krerëve 3901 deri në 3914, të NKM-së.

Përveç materialeve/artikujve të importuar në kapitullin 39 të NKM-së, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Në rastet kur në materialet/artikujt që importohen në kapitullin 39 të NKM-së, pjesa joplastike zë më shumë se 51 për qind të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës së plastikës (si p.sh., dyer, dritare etj...).

2.8.2 Taksa e lëndëve të para në forma primare të importuara, që klasifikohen në krerët 3901 deri në 3914 të NKM-së, dhe që përdoren për prodhimin në vend të produkteve të plastikës është ~~25 lekë/kg~~ 10 lekë/kg.

(Zëvendësuar me Udhëzimin Nr. 27, dt.09.10.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 09.10.2019)

2.8.3 Taksa e ambalazheve prej qelqi është 5 lekë/kg dhe zbatohet për ambalazhet prej qelqi të importuara e të prodhuara në vend. Taksa zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi, sipas kreut 7010 të NKM-së, në rast se ambalazhi importohet veçmas si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

### 2.8.4 Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e taksës:

Administrata Doganore është përgjegjëse për mbledhjen e:

- Taksës së materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike të importuara;
- Taksës së lëndëve të para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së, dhe që përdoren për prodhimin në vend të produkteve të plastikës;
- Taksës së ambalazheve prej qelqi të importuara;

Administrata Tatimore është përgjegjëse për mbledhjen e:

- Taksës së ambalazheve prej qelqi të prodhuara në vend.

### 2.8.5 Pagesa dhe transferimi në llogarinë e të ardhurave tatimore të taksës.

Pagesa e taksës nga importuesi sipas pikave “a”; “b” dhe “c”, të paragrafit 2.8.4 më lart, bëhet në momentin e importit të tyre, para se këto mallra të jenë liruar për qarkullim të lire.

Pagesa e taksës nga prodhuesi vendas sipas pikës “d”; të paragrafit 2.8.4 më lart, bëhet së bashku me dorëzimin e deklaratës së taksave kombëtare, brenda datës 15 të muajit pasardhës për muajin paraardhës.

Transferimi nga Administrata Doganore e të ardhurave të arkëtuara nga taksa, në llogarinë e të ardhurave të Administratës Tatimore bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës për muajin paraardhës.

2.8.6 Procedurat e deklarimit në import dhe pagimit të taksës për ambalazhet plastike dhe/ose qelqi

i. Për qëllime të aplikimit të taksës për ambalazhin plastik/qelqi të importuar, subjekti importues, vetë, apo nëpërmjet kompanisë prodhuese apo eksportuese, bën ndarjen e llojeve të ambalazhit të produkteve të importuara.

Deklarimi i ambalazhit në DAV në import bëhet në nivel artikulli. Kur për të njëjtin artikull ka

ambalazhe të ndryshme, sipas kategorizimit plastikë apo qelq, detyrimisht në DAV, për artikujt me kod tarifor të njëjtë, do të bëhet deklarimi i ndarë (me BIS), por me kod të ndryshëm ambalazhi (kutia 31 e DAV).

ii. Në llogaritjen e taksës për ambalazhin plastik, nga pesha bruto, do të zbritet pesha e paletave të drurit, paletave të kartonit dhe paletave metalike.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 28.04.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 72 datë 04.05.2023)

Shembuj:

a) Në rast se importuesi deklaron ambalazh plastik sipas kodeve tarifore nga kreu 3916 deri 3926 të NKM-së, taksa do të llogaritet mbi bazën e peshës neto, duke aplikuar nivel taksimi 35 lekë/kg;

b) Në rast se importuesi deklaron mallra në ambalazh qelqi, sipas kodeve tarifore të kreut 7010 të NK-së, taksa do të llogaritet mbi bazën e peshës neto, duke aplikuar nivel taksimi 5 lekë/kg;

c) Në rast se importuesi deklaron mallra të klasifikuara në kode të tjera tarifore të NKM-së, në kutinë 31 të DAV, përdoret kodi përkatës I ambalazhit plastik dhe taksa zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 35 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV, si peshë neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi;

d) Në rast se importuesi deklaron mallra të klasifikuara në kode tarifore të tjera të NKM-së, në kutinë 31 të DAV përdoret kodi përkatës I ambalazhit të qelqit, dhe taksa zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 5 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV si peshë neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi;

e) Në rast se importuesi deklaron se në të njëjtën ngarkesë, ndodhen mallra që janë të klasifikuara në krerët 3923 dhe 7010 të NKM-së (edhe ambalazh plastik bosh, edhe ambalazh qelqi bosh), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (me BIS) dhe llogaritja e taksës për çdo artikull bëhet për diferencën e peshës bruto me atë neto;

f) Në rast se importuesi deklaron, se në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë të paketuara në ambalazh plastik dhe qelqi (p.sh. vaj vegjetal i ambalazhuar një pjesë në shishe plastike dhe një pjesë në shishe qelqi), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (me BIS), duke përdorur kode të ndryshme ambalazhi për sasi të respektive. Llogaritja e taksës për çdo artikull bëhet për diferencën e peshës bruto me atë neto;

g) Në rast se importuesi deklaron produkteve gjysmë të gatshme (p.sh. pipeta), të cilat destinohen për prodhimin e ambalazheve të plastikës apo të qelqit, taksa llogaritet dhe paguhet në import, para çlirimit për qarkullim të lirë, pavarësisht nëse importuesi i importon

këto produkte në funksion të aktivitetit të vet prodhues apo është importues I këtyre produkteve për qëllime tregtare.

2.8.7 Procedura e deklarimit të ambalazheve të qelqit nga prodhuesit vendas Për ambalazhet prej qelqi të prodhuara në vend, taksa përfshihet në vlerën e tatueshme të faturës, para se të aplikohet TVSH-ja. Subjekti prodhues I ndan në faturën tatimore artikujt sipas kapacitetit mbajtës të ambalazhit.

Në rastet kur subjektet prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh qelqi, e prodhojnë vetë ambalazhin dhe e shesin atë edhe për të tretë, paguajnë taksën për sasinë e shitur të ambalazhit me faturë tatimore, si dhe për sasinë e përdorur të ambalazhit për nevojat e ambalazhimit të produkteve të tyre.

2.8.8 Procedura e kontrollit të lëndëve të para në forma primare të importuara në krerët 3901 deri në 3914 të NKM-së, në rastet kur nuk përdoren për prodhimin në vend të produkteve të plastikës.

2.8.8.1 Taksa ~~25~~ 10 lekë/kg për lëndët e para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së, zbatohet për të gjithë prodhuesit/importuesit që e përdorin për prodhimin në vend të produkteve të plastikës.

(Zëvendësuar me Udhëzimin Nr. 27, dt.09.10.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 09.10.2019)

Taksa për lëndët e para në forma primare të importuara ~~nga subjektet prodhuese~~, që kategorizohen në krerët 3901 deri në 3914, do të aplikohet vetëm nëse produktet e prodhuara nga këto lëndë të para të importuara janë subjekt I llogaritjes së taksës në import.

~~Në rastet kur lëndët e para në forma primare, të importuara nga subjektet prodhuese dhe që klasifikohen në krerët 3901 deri në 3914, nuk përdoren për prodhimin e produkteve të plastikës në vend, por si plotësues teknologjik, lëndë të para additive (agregate lidhës) për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si produkte plastike, taksa 25 lekë/kg nuk paguhet në import.~~

~~Ky përcaktim zbatohet dhe për rastet kur lëndët e para në forma primare, të importuara nga subjektet prodhuese në krerët 3901 deri në 3914, përdoren për prodhimin e materialeve plotësuese për prodhues të tjerë, produktet finale të të cilëve nuk përfshihen në kapitullin 39 të NKM-së.~~

~~(Shfuqizuar me Udhëzimin Nr. 27, dt.09.10.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 09.10.2019)~~

~~(Hequr togfjalëshi me Udhëzimin Nr.11 datë 15.03.2019, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.35 datë 21.03.2019 )~~

#### **Shembuj:**

Për përjashtimet e përcaktuara më poshtë sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “d”, procedura sipas pikave 2.8.8.2 dhe 2.8.8.3 aplikohet vetëm për lëndët e para në formë primare që klasifikohen në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së.

(Zëvendësuar me Udhëzimin Nr. 8, datë 14.02.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 25, datë 28.02.2020)

a) lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar, të përfshira në kodet nga 3901 deri 3914 të NKM-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para aditive (agregate lidhëse), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastikë. Taksa për lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar do të aplikohet vetëm nëse materialet/artikujt e prodhuar nga këto lëndë të para janë subjekt i llogaritjes së taksës në rast se këto materiale/artikuj do të importohen;

b) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (EPS expanded polysterene), të përfshira në kodet nga 3901 deri 3914 të NKM-së, importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (XPS extruder polystyrene), të përfshira në kodet 3920 30 00–prej polimereve të stirenit dhe

3921 11 00 —prej polimereve të stirenit, si dhe profileve PVC për prodhimin e dyerve dhe dritareve, të cilat përfshihen në kodin 3916 20 00 –prej polimereve të vinil kloridit, të NKM-së, artikuj të cilët përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të eficiencës së energjisë;

c) lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve të përfshira në kodet nga 3901 deri 3914 të NKM-së, si dhe importimi i sfungjerit, të klasifikuar në krrerët 3920 –pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjerë, prej plastike, jocelulare dhe jo të përforcuara, jo të laminuara të pambështetura apo të pakombinuara në mënyra të ngjashme me materiale të tjera dhe 3921– pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjerë, prej plastike. Importimi i artikujve të cilët përdoren në industrinë e mobilierisë të klasifikuara në krrerët 3920 –pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjerë, prej plastike, jocelulare dhe jo të perforcuara, jo të laminuara, të pambështetura apo të pakombinuara në mënyra të ngjashme me materiale të tjera dhe 3921– pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjera, prej plastike, nënkreun 3926 30 --përshtatjet për mobilieritë dhe kodin 3926 90 97----të tjera.

d)lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta të përfshira në kodet nga 3901 deri 3914 apo materialet celuloike, sipas kodit 3917 10 –zorrrë artificiale (mbajtësit e sallamit) prej proteinave të forta apo prej materialeve celulozike të NKM-së, të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve.”

(Shtuar me Udhëzimin Nr. 27, dt.09.10.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 09.10.2019)

2.8.8.2 Subjektet importuese, të cilat përdorin lëndë të parë, apo material ndihmës importi të kategorizuar në kodet 3901 deri në 3914, të NKM-së, por që janë prodhues apo tregtues të mallrave/materialeve që nuk kategorizohen në grupin e produkteve të plastikës, ose që produktet apo materialet ndihmëse të tyre, përdoren për prodhimin e materialeve plotësuese për prodhues të tjerë, produktet finale të të cilëve nuk përfshihen në kapitullin 39 në NKM-së, depozitojnë në Drejtorinë Rajonale Tatimore për përjashtimin e taksës 25 lekë/kg në import dokumentacionin e mëposhtëm:

(Shtuar me Udhëzimin Nr.11 datë 15.03.2019, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.35 datë 21.03.2019)

a) Licencë/leje/miratim nga institucioni përkatës i autorizuar (nëse kërkohet nga legjislacioni), për prodhimin e produkteve joplastike, por që përdorin edhe lëndë ndihmëse që kategorizohen në kodet 3901 deri në 3914, të NKM-së.

b) Listën e detajuar të mallrave dhe materialeve që prodhon apo tregton, përfshirë edhe kodin e tyre në rastet kur këto mallra apo materiale importohen.

(Shtuar me Udhëzimin Nr.11 datë 15.03.2019, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.35 datë 21.03.2019)

~~e) Kartën teknologjike të procesit të prodhimit ku përcaktohen sasi të materialeve që kategorizohen në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së të nevojshme për prodhimin e produkteve joplastike.~~

~~d) Për rastet kur produktet/materialet janë materiale plotësuese për prodhues të tjerë produktesh finale, të cilat nuk përfshihen në kapitullin 39 në NKM-së, dokumente të tilla si kontratat, apo porositë me blerësin e këtyre materialeve plotësuese, si p.sh., me një prodhues mobiliesh.~~

(Hequr me Udhëzimin Nr.11 datë 15.03.2019, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.35 datë 21.03.2019)

~~e) Nevojat tremujore dhe vjetore të importit të materialeve që kategorizohen në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së, të nevojshme për procesin teknologjik.~~

(Shfuqizuar me Udhëzimin Nr. 27, dt.09.10.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 09.10.2019)



f) Të dhënat ~~tremujore dhe~~ vjetore të produkteve jo plastike të prodhuara dhe për të cilat janë përdorur materiale të importuara në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së.

(Shfuqizuar me Udhëzimin Nr. 27, dt.09.10.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 09.10.2019)

g) Gjendja e inventarit tremujor dhe në fund të vitit e materialeve të importuara për qëllime prodhimi, në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së. Subjektet importues të pajisur me autorizim nga Drejtoria Rajonale Tatimore për mospagesën e taksës për importimin ~~nga vetë prodhuesi~~ për

qëllime prodhimi të mallrave joplastike, të materialeve sipas kodeve 3901 deri në 3914 të NKM-së, që kanë bërë pagesën nga data 1 janar 2019 deri në datën e publikimit në Fletoren Zyrtare të këtij udhëzimi, rimbursohen nga Dega Doganore ku ka kryer importin. Procedura e rimbursimit bëhet *mutatis-mutandis* sipas pikës 2.8.9.

(Hequr me Udhëzimin Nr.11 datë 15.03.2019, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.35 datë 21.03.2019)

#### 2.8.8.3. Drejtoria Rajonale Tatimore:

a) krijon dosje për çdo importues që prodhon vetëprodukte jo plastike apo materiale plotësuese

për një kategori tjetër prodhimi që prodhon produkte jo plastike, duke përdorur edhe materialeve të importuara nga ai vetë për qëllime prodhimi, në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së;

b) dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

i. kopje të dosjes për subjektin importues i cili prodhon mallra dhe materiale joplastike;

ii. autorizimin me shkrim për mospagesën e taksës për importimin ~~nga vetë prodhuesi~~ për qëllime prodhimi të mallrave joplastike, të materialeve sipas kodeve 3901 deri në 3914 të NKM-së;

(Hequr me Udhëzimin Nr.11 datë 15.03.2019, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.35 datë 21.03.2019)

iii. revokimin anulimin apo ndryshimin e autorizimit kur konstaton se importet e materialeve sipas kodeve 3901 deri në 3914 të NKM-së nuk janë përdorur për prodhimin e mallrave joplastikë.

c) monitoron dhe kontrollon përdorimin e materialeve sipas kodeve 3901 deri në 3914 të NKM-së, për të cilat taksa nuk është paguar.

2.8.9 Rimbursimi i taksës në rastet e eksportit për ambalazhet plastike/qelqi, ~~lëndën e parë, si dhe materialet/artikujt prej plastike~~ të cilat eksportohen, dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit/prodhimit të tyre, bëhet rimbursimi i saj. Administrata Doganore rimbursion taksën për sasinë e eksportuar ~~të ambalazhit~~ si më vijon:

a) Në rast se eksportuesi është importues dhe/ose prodhues vendas dhe ka paguar në import taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi, ~~lëndën e parë, si dhe materialet/artikujt prej plastike~~ në momentin e importit, Administrata Doganore rimbursion për të gjithë sasinë e eksportuar ~~të ambalazhit~~ sipas nivelit të taksimit.

b) Rimbursimi behet edhe për subjektet eksportuese të cilët janë furnizuar me ambalazhe prej plastike/qelqi, ~~lëndën e parë, si dhe materialet/artikujt prej plastike~~ nga importues vendas, të cilët e kanë paguar taksën e këtyre ambalazheve në momentin e importit.

Në rast se eksportuesi është prodhues vendas dhe ka paguar në import taksën e lëndëve të para në forma primare, të importuara në koderat 3901 deri në 3914, të NKM-së, e cila përdoret për prodhimin në vend të produkteve të plastikës, Administrata Doganore rimbursion në masën respektive të lëndës së parë të përdorur për të gjithë sasinë ~~e ambalazhit~~ që eksportohet sipas nivelit të taksimit.

Rimbursimi për taksën e paguar për lëndët e para bëhet edhe për subjektet eksportuese të cilët



janë furnizuar me ambalazhe prej plastike, nga prodhues vendas që e kanë paguar këtë taksë në momentin e importit.

c) Administrata Doganore bën rimbursimin e taksës duke përdorur të ardhurat e arkëtuara nga kjo taksë në muajin korrent kur bëhet rimbursimi. Në muajin pasardhës, Administrata Doganore transferon taksën e arkëtuar në llogarinë e Administratës Tatimore, duke sqaruar shumën bruto të arkëtuar në muajin paraardhës, rimbursimin e kryer për sasinë e eksportuar, si dhe shumën neto të transferuar.

(Shtuar dhe hequr me Udhëzimin Nr. 27, dt.09.10.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 09.10.2019)

2.8.9.1 Rimbursimi i taksës mund të bëhet kundrejt plotësimit të aplikimit dhe marrjes së vendimit, sipas aneksit 33–07, shtojcat A dhe B, të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat

zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor I Republikës së Shqipërisë”.

Aplikimi i drejtohet zyrës doganore mbikëqyrëse dhe duhet të përmbajë:

- a) llojin e aktivitetit;
- b) llojin e mallit;
- c) shumën për të cilën kërkohet rimbursim;
- d) arsyet e kërimit të rimbursimit;
- e) nivelin e taksimit të zbatuar në momentin e pagesës;
- f) destinacionin e mallit;
- g) mënyrën e identifikimit të mallrave;
- h) dokumentacionin respektiv me të cilin është kryer pagesa e taksës (DAV, faturë tatimore etj.).

i) kur është rasti, masën respektive të lëndës së parë të përdorur për të gjithë sasinë e ambalazhit që eksportohet, sipas kartës teknologjike të depozituar në Drejtorinë Rajonale Tatimore.

Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, administrata doganore kërkon me shkrim dokumentacionin e munguar, brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Pas depozitimit të dokumentacionit të kërkuar sipas këtij paragrafi, administrata doganore njofton me shkrim, brenda 7 ditëve, tatimpaguesin mbi aplikimin e dorëzuar”.

(Shtuar me Udhëzimin Nr. 27, dt.09.10.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 09.10.2019)

2.8.9.2 Aplikimit për rimbursim i bashkëngjitet dokumentacioni për produktin, për të cilin kërkohet rimbursimi i taksës dhe pagesat që janë kryer për produktin, objekt rimbursimi. Rimbursimi i taksës mund të kërkohet deri në 1 vit nga data e pagesës së taksës në import.

2.9 Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim.

Niveli, aplikimi dhe llogaritja e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim, bëhet sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 10270 , datë 22.04.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Të gjithë personat juridikë dhe fizikë, subjekte të kësaj takse, janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të mësipërme, si dhe me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi

2.10 Taksa mbi primet e shkruara , me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil.Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të

primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 3 (tre) përqind e shumës së primit.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

Taksa mbi primet e shkruara me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është në masën 10 për qind e shumës së primit e llogaritur sipas shembullit të mëposhtëm.

Primi i llogaritur sipas legjislacionit që rregullon veprimtarinë në tregun e sigurimeve është në masën 10.000 lekë, atëherë taksa mbi primin që llogaritet prej 10% është 1000 lekë (10000\*10%). Primi i shkruar bashkë me taksën është 11000 lekë.

	<b>Vlera</b>
Primi i shkruar	10000
Taksa mbi primin 10%	1000
<b>Totali</b>	<b>11000</b>

Taksa e primit evidentohet veçmas nga primi i shkruar. Në rolin e agentit të taksës mbi primet e shkruara, shoqëria e sigurimeve është përgjegjëse për llogaritjen, deklarimin, mbledhjen dhe pagesën e taksës së primit të shkruar për llogari të organit tatimor. Shuma totale e primeve të shkruara të faturuara gjatë muajit, si dhe taksa prej 10% e tyre deklarohet dhe paguhet nga shoqëria e sigurimeve deri në datën 15 të muajit pasardhës të muajit, për të cilin janë faturuar primet e sigurimit, në deklaratën mujore të taksave kombëtare.

#### 2.11. Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze.

Në kuptim të ligjit për taksat kombëtare dhe të këtij udhëzimi, “automjet luksoz” konsiderohet autovetura deri në 6+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm<sup>3</sup>;  
ose

b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë. Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbi makinat luksoze zbatohet taksë regjistrimi fillestar në masën 70 000 lekë për regjistrim të çdo makine luksoze dhe taksë e përvitshme në masën 21 000 lekë çdo vit. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si agjente e përcaktuar nga ligji për mbledhjen e këtyre taksave, deklaron dhe paguan taksën e mjeteve të përdorura të transportit, në administratën tatimore në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi. Pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “c” dhe “d” me këtë përmbajtje:

c. Vlera e mjetit plotësohet në sistemin informatik të DPSHTRR-së në fushën “vlera e mjetit”, kur:

- mjeti regjistrohet për herë të parë;
- ose/dhe sa herë ndryshon pronësia e tij;
- si dhe kur nga kontrolli i dokumentacionit financiar në dosjen e mjetit është konstatuar se vlera e mjetit në sistemin informatik të DPSHTRR-së nuk është vlera e duhur, referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për mjetet që kryejnë regjistrim për herë të parë në DPSHTRR, vlera e mjetit do të merret nga:

- Deklarata me referencë doganore DAV, e cila llogaritet si totali i vlerës së tatueshme (baza e tatueshme) mbi të cilën llogaritet tatimi mbi vlerën e shtuar dhe duke i shtuar TVSH-në e llogaritur në doganë (Totali = Baza e tatueshme + TVSH);

- Fatura tatimore e shitjes, e cila është vlera totale e barabartë me vlerën e tatueshme duke i shtuar dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

- Për rastet me kontratë të qirasë financiare (leasing), do të merret vlera totale në kontratën e qirasë financiare dhe jo vlera në kontratën e furnizimit (kontratë shitjeje), e cila i shërben qiramarrësit për njohjen faktike të pronësisë së automjetit nga qiradhënësi te qiramarrësi dhe që lidhet midis palëve vetëm pas shlyerjes prej qiramarrësit të këstit të fundit të qirasë financiare.

- Në rast se për të njëjtin mjet disponohen dy ose më shumë dokumente, si për shembull, deklaratë me referencë doganore DAV dhe faturë tatimore shitje, gjithmonë do të merret për t'u regjistruar në fushën "vlera e mjetit", vlera totale e mjetit që është më e madhe në këto dokumente.

- Vlera e mjetit në sistemin informatik të DPSHTRR-së do të plotësohet në monedhën lekë dhe në rast se vlera e mjetit nga dokumentacioni shoqëruar është në monedhë tjetër, do të llogaritet vlera korresponduese në lekë, referuar kursit ditor të Bankës së Shqipërisë sipas datës së dokumentit në monedhë të huaj, printimi i së cilës pasi vulozet nga specialisti përkatës i bashkëlidhet dokumenteve.

d. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit "Automjet luksoz", reduktohet (amortizohet) jo më shumë se 10% të vlerës së mbetur çdo vit, duke marrë si vlerë fillestare për efekt reduktimi (amortizimi) vlerën e fundit të regjistruar në sistem.

- Për mjetet që janë të regjistruara në sistemin e DPSHRR-së, të cilat shiten ose ndryshojnë pronësinë në një nga format e njohura nga Kodi Civil (kontratë shitblerjeje, kalim kapitali, dhurimi, dëshmi trashëgimie, faturë tatimore shitje etj.), vlera e mjetit për efekt klasifikimi si "Automjet luksoz", duke filluar nga 15 janari i vitit 2020 e në vazhdim, nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mbetur e reduktuar (amortizuar) në fushën "vlera e mjetit" në sistem nga pronësia e fundit e tij, por është vlera më e madhe ndërmjet vlerës në dokumentin e fitimit të pronësisë dhe vlerës së mbetur të reduktuar (amortizuar).

- Për çdo vit të plotë reduktimi (amortizimi) i vlerës së mjetit është 10% e vlerës së mbetur. Për vitin kur mjeti regjistrohet për herë të parë, ndryshon pronësinë, çregjistrohet etj., reduktimi (amortizimi) i vlerës së mjetit do të jetë në raport me muajt e plotë pa përfshirë muajin e regjistrimit, muajin e ndryshimit të pronësisë ose muajin çregjistrimit në sistemin e DPSHTRR-së (vlera e mjetit e reduktuar (amortizuar) në fushën "vlera e mjetit" X 10% / 12 muaj X muajt e plotë pa përfshirë muajin e ndryshimit të pronësisë).

- Për mjetet të cilat janë debitore për pagesën e taksës së përvitshme për automjetet luksoze për vitet 2016–2019, detyrimet do të llogariten dhe arkëtohen në bazë të vlerës që mjeti kishte në sistemin informatik të DPSHTRR-së ose në dokumentin e fitimit të pronësisë që ndodhet në dosjen e mjetit.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 8, datë 14.02.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 25, datë 28.02.2020)

2.11.1 Taksa e regjistrimit fillestar për automjetet luksoze paguhet nga pronari i mjetit në momentin e regjistrimit fillestar të mjetit në drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor. Për efekt të taksës së regjistrimit fillestar për automjetet luksoze, për të vërtetuar se një automjet është luksoz apo jo, verifikimi bëhet me dokumentin teknik të origjinës së mjetit ku është përcaktuar nëse cilindrata e automjetit është e barabarte ose me e madhe se 3000

cm3 , ose nga dokumentet financiare shoqëruese të mjetit si kontratë noteriale, faturë shitje, deklaratë me referencën doganore DAV etj., ku është e përcaktuar se vlera/çmimi i automjetit është i barabartë ose më shumë se 5,000,000 lekë.

2.11.2 Taksa e përvitshme për automjetet luksoze është taksë vjetore për çdo vit kalendarik nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit përkatës për të cilën llogaritet dhe paguhet dhe ka vlefshmëri 365 ditë, pavarësisht nga momenti në të cilën ajo paguhet. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. Kjo taksë paguhet në të njëjtin moment kur paguhet taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit. E ardhura nga kjo taksë, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, në momentin e vjeljes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë gjobë për shumën e detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë nga dita e fundit e vlefshmërisë. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturën e taksës vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP)-së”. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me organet e tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike. DPSHTRR-ja, si agjent për llogaritjen dhe arkëtimin e taksës së regjistrimit fillestar dhe taksës së përvitshme për automjetet luksoze, përfiton 5 (pesë) për qind të shumës së arkëtuar. DPSHTRR-ja nga shuma mujore e arkëtuar nga taksa e regjistrimit fillestar (TRML) dhe taksa e përvitshme për automjetet luksoze (TVML), pasi mban komisionin prej 5 (pesë) % të totalit mujor të arkëtimeve nga TRML-ja dhe TVML-ja, pjesën tjetër të mbetur prej 95 (nëntëdhjetë e pesë) % e derdh për llogari të drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar (Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj) brenda datës 15 të muajit pasardhës. Rakordimi i pagesës së TRML-së dhe TVML-së ndërmjet strukturave të DPSHTRR-së me organet tatimore të qeverisjes qendrore bëhet në bazë të regjistrit ditor të taksës së regjistrimit fillestar dhe taksës së përvitshme për automjetet luksoze.”.

Shembull:

Mjeti me targë AAxxxAA është regjistruar ose ka bërë ndryshimin e pronësisë në sistemin me datë 30.1.2020 dhe vlera më e madhe e mjetit ndërmjet dokumentacionit financiar dhe vlerës së mbetur të reduktuar (amortizuar) në fushën “vlera e mjetit” është 5,800,000 lekë. Më datën 10.4.2021 paraqitet për të bërë regjistrimin e ndryshimin e pronësisë së mjetit sipas kontratës së shitblerjes me vlerë 3,900,000 lekë. Vlera e mjetit e reduktuar (amortizuar) në raport me muajt e plotë të çdo viti, pa përfshirë muajin e ndryshimit të pronësisë më datë 10.4.2021 është 5,136,625 lekë.

Për efekt të klasifikimit si “Automjet luksoz” vlera më e madhe ndërmjet vlerës në dokumentin financiar të fitimit të pronësisë dhe vlerës së reduktuar në fushën “vlera e mjetit” do të merret parasysh vlera më e madhe që është 5,136,625 lekë.

Shembull:

Pronari i mjetit me targë AAxxxAA me cilindrata 3200 cc, me naftë, viti i prodhimit 2011, i regjistruar në sistemin informatik e DPSHTRR-së më 2.10.2014, i cili ka paguar detyrimet e TVMP-së dhe të TVML-së të vitit 2018, më 25.12.2018, me afat vlefshmërie deri më 25.12.2019, paraqitet për të bërë çregjistrimin e përhershëm të mjetit pranë zyrave të DPSHTRR-së, më datën 20.4.2020.

Përpara çregjistrimit të përhershëm të mjetit i llogariten dhe duhet të paguhen detyrimet e TVMP-së dhe të TVML-së dhe gjobën përkatëse për vitin 2019 dhe periudhën janar–prill 2020.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 8, datë 14.02.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 25, datë 28.02.2020)

Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë taksën e përvitshme për automjetet luksoze në raport me kohën e hyrjes në qarkullim në territorin e Shqipërisë. Në rast se mjeti regjistrohet në muajin janar, TVML-ja paguhet e plotë, ndërsa për periudhën në vazhdim në raport me muajt e hyrjes në qarkullim, pavarësisht datës së muajit. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, por që në momentin e targimit kërkohet të bëhet njëkohësisht edhe procedura e çregjistrimit të përkohshëm të tyre, detyrimet për TVML llogariten dhe paguhen për muajin në të cilin mjeti do të regjistrohet, ndërkohë që bëhet edhe procedura e çregjistrimit të tij, duke dorëzuar targat dhe lejen e qarkullimi.

Shembull: Subjekti/qytetari, paraqitet në DRSHTRR për të regjistruar mjetin me cilindrata 3628 cm<sup>3</sup>, lloji i karburantit naftë, vit prodhimi 2008, por njëkohësisht kërkon të bëjë çregjistrimin e përkohshëm për këtë mjet. Për mjetin në fjalë, punonjësi i DRSHTRR do të bëjë regjistrimin sipas procedurave përkatëse, do llogarisë dhe arkëtojë për një muaj TVMP-në në shumën 1.058 lekë, TRML-në do ta llogarisë dhe arkëtojë të plotë, si dhe do të llogarisë dhe arkëtojë TVML-në për një muaj në shumën 1.750 lekë. Njëkohësisht do të mbahen targat dhe leja e qarkullimi për këtë mjet sipas procedurave përkatëse. Kur subjekti/qytetari pronar i mjetit do të paraqitet pranë DRSHTRR-së për të rikthyer në qarkullim mjetin, p.sh., në datën 12.07.2019, nga ana e punonjësit përkatës do të llogaritet dhe arkëtohet diferenca e TVMP-së për 6 muaj, korrik hjeter 2019, në shumën 6.348 lekë dhe TVML-së për 6 muaj korrik–dhjetor 2019 në shumën 10.500 lekë, si dhe do të bëhet rikthimi në qarkullim i këtij mjeti sipas procedurave të përcaktuara.

Për mjetet që dalin përfundimisht nga qarkullimi, në momentin e paraqitjes së qytetarit për çregjistrimin e përhershëm, llogaritja e vlerës së taksës do të jetë e barabartë në raport me periudhën, që mjeti ka qenë në qarkullim.

Shembull: Mjeti me cilindrata 3628 cm<sup>3</sup>, me naftë dhe vit prodhimi 2008, për vitin 2015 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 27.12.2015, për vlerën 9,524 lekë. Në datën 12.1.2017 pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksën e vitit 2016. Mjetit i ka kaluar afati më shumë se 10 ditë nga afati i vlefshmërisë së taksës, pra llogaritet me 1 muaj vonesë për pagesën e TVMP-së për vitin 2016. Për këtë arsye, pronari i mjetit duhet të paguajë TVMP e vitit 2016 në shumën 9,977 si dhe 5% gjobë mbi shumën e taksës së TVMP-së në shumën 499 lekë. Shuma totale e TVMP-së që duhet të paguajë për vitin 2016 është 16,163 lekë. Gjithashtu, nëse mjeti është me cilindrata më të madhe ose të barabartë me 3000 cm<sup>3</sup>, detyrohet të paguajë edhe TVML për vitin 2016 në shumën 21,000 lekë dhe gjobë për TVML prej 5% në shumën 1,050 lekë. Shuma totale e taksave (TVMP+TVML) që pronari i mjetit duhet të paguajë për vitin 2016 është në shumën 32,526 lekë.

Nga ana tjetër, duke qenë se subjekti është paraqitur më datë 12.1.2017, i ka mbaruar afati i vlefshmërisë së taksave për këtë mjet, detyrohet të paguajë edhe detyrimet për TVMP për vitin 2017, në vlerën 10,431 lekë dhe vlera e gjobës prej 5% për një muaj vonesë që është në vlerën 522 lekë. Shuma totale që subjekti detyrohet të paguajë është 10,953 lekë. Afati i vlefshmërisë për vitin 2017 fillon nga data 1.1.2017. Gjithashtu, subjekti ka detyrimin të paguajë edhe TVML për vitin 2017 në shumën 21,000 lekë dhe gjobë prej 5% në shumën 1,050 lekë. Shuma totale e taksave për vitin 2017 është në shumën 33,003 lekë me afat vlefshmërie deri në 12.1.2018.

Shembull: Pronari i mjetit me cilindrata 3653 cm<sup>3</sup>, me benzinë dhe vit prodhimi 2006, paraqitet pranë strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për të regjistruar për herë të parë mjetin më datë 16.6.2017. Në datën 16.6.2017 pronari i



mjetit ka detyrimin të paguajë TVMP-në për 7-muaj të vitit 2017 në shumën 5,966 lekë ( $3653 \cdot 0.28 \cdot 10 = 10,228 / 12 \cdot 7$ ).

Duke qenë se është me cilindrata më të madhe ose të barabartë me 3000 cm<sup>3</sup> duhet të paguajë dhe TRML në shumën 70,000 lekë dhe TVML për 7 muaj të vitit 2017 në shumën 12,250 ( $21,000 / 12 \cdot 7$ ) lekë. Vlera totale e taksave (TVMP+TVML) që pronari i mjetit duhet të paguajë për vitin 2017 është 88,216 lekë.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në FZ. nr. 72, datë 10 prill 2017).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 14, datë 30.04.2018, botuar në FZ Nr.65, datë 7 maj 2018).

2.11.3 Në zbatim të nenit 23, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, kur nga kontrolli i dosjes së mjetit konstatohet se vlera e mjetit, cilindrata, lloji i mjetit, lloji i karburantit, viti i prodhimit, numri i vendeve etj., nuk është e njëjtë me të dhënat e regjistruara në sistemin informatik e DPSHTRR-së, e për rrjedhojë lind një detyrim i ri për taksën, krahas masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të agentit tatimor, drejtuar taksapaguesve, u dërgohen atyre në adresën e deklaruar nga vetë ato.

Këto njoftime i dërgohen taksapaguesit në rrugë elektronike, në rastin kur ai ka dhënë pëlqimin për pranimin e komunikimit në rrugë elektronike dhe është regjistruar si përdorues i shërbimit të sistemit të komunikimit elektronik, dhe nëpërmjet shërbimit postar në adresën e banimit të pronarit të mjetit sipas regjistrimit të gjendjes civile ose në adresës e selisë së tij deklaruar në QKB.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në rolin e agentit gjatë ushtrimit të funksionit të tij për mbledhjen e taksës, zbaton rregullat, parimet dhe procedurat e parashikuara në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Shtuar me Udhëzimin Nr. 8, datë 14.02.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 25, datë 28.02.2020)

2.12 Taksa për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur është në vlerën 100 lekë/kg.

2.13 Taksa për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara është në vlerën 16 lekë/litrë.

2.14 Taksa për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit është në vlerën 150 lekë/litrë.

2.15 Taksa për importimin dhe prodhimin e krem qumështit është në vlerën 150 lekë/litrë.

Taksat e përcaktuara në paragrafët 2.12 deri në 2.15 zbatohen si për sasi të importuara nga personat e tatueshëm, ashtu edhe për sasi të prodhuara në vend.

Për qumështin pluhur, pijet e homogjenizuara, hirrën e qumështit dhe kremin e qumështit të importuar, importuesi e paguan taksën pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e çlirimit për qarkullim të lirë, në momentin e kryerjes së këtyre procedurave.

Për këto produkte të prodhuara në vend, deklarimi dhe pagesa e taksës në administratën tatimore bëhet nga çdo tatimpagues prodhues së bashku me dorëzimin e deklaratës së taksave kombëtare, brenda datës 15 të muajit pasardhës për muajin paraardhës.

Transferimi nga Administrata Doganore i të ardhurave të arkëtuara nga taksa, në llogarinë e të ardhurave të Administratës Tatimore bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës për muajin paraardhës, sipas deklaratës së taksave kombëtare.

2.16 Taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, është në vlerën 40 lekë/litri.



Taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi paguhet nga personi i tatueshëm, pranë degëve doganore në momentin e regjistrimit të deklaratës doganore të eksportit ose rieksporit për këtë qellim.

(Shtuar me Udhëzimin nr.3, datë. 31.01. 2022, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 17. datë 02.02.2022).

### 3. Përgjithshme nga taksat kombëtare

(Ndryshuar me udhëzim nr.25, dt. 19.07. 2010, botuar ne Fl.Z. Nr. 94. dt. 22 korrik 2010).

#### 3.1. Përgjithshme nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b. Personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm njëherë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë.

b.1 pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjete ka qenë i bllokuar, dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

c. autoveturat tip deri në 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat me aftësi të kufizuar që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private. Për veteranët e luftës për përjashtimin nga TVMP-ja, për çdo vit përjashtimi bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës dhe duhet që:

i. Dosja e mjetit e qytetarit me status “veteran lufte” dhe dosja e invaliditetit e tij duhet të jenë nën juridiksionin territorial të drejtorisë rajonale ku ka vendbanimin qytetari me status “veteran lufte” sipas regjistrimit të gjendjes civile.

ii. Të jetë i pajisur me “Librezën e veteranit”, në zbatim të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar”, i ndryshuar.

iii. Vërtetimin e siguruar nga vetë qytetari me status “veteran lufte” nëpërmjet portalit e-albania, kjo në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, që nuk zhvillon aktivitet privat.

iv. Kartën e identitetit të vlefshme të personit me status “veteran lufte” që ka në pronësi mjetin.

Për invalidët e punës, personat e verbër, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe personat me aftësi të kufizuar, për përjashtimin nga TVMP-ja, për çdo vit përjashtimi bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të qytetarit me status “invalid” dhe duhet që:

i. Dosja e mjetit e qytetarit me status “invalid” dhe dosja e invaliditetit e tij duhet të jenë nën juridiksionin territorial të drejtorisë rajonale ku ka vendbanimin qytetari me status “invalid” sipas regjistrit të gjendjes civile.

ii. Të jetë i pajisur me librezën e invaliditetit, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar, ose librezën e verbërisë, ose librezën e paraplegjiku/tetraplegjiku lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, pasi verifikohet vlefshmëria e tyre fotokopjohet dhe mbahet nga strukturat e DPSHTRR-së.

iii. Vërtetim të KMCAp-it, i siguruar nga vetë qytetari me status “invalid”, nëpërmjet portalit e-albania, kjo në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike” ose vërtetimin origjinal të KMCAp-it ose i noterizuar, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën përkatëse të invaliditetit ose kopje e vendimin të Komisionit të Përcaktimit të Verbërisë lëshuar nga Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë KMCAp-it për personat e verbër pasi verifikohet origjinali.

iv. Vërtetimin, e siguruar nga vetë qytetari me status “invalid”, nëpërmjet portalit e-albania, në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”, që nuk zhvillon aktivitet privat.

v. Kartën e identitetit të vlefshme të personit me status “invalid” që ka në pronësi mjetin. (Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 8, datë 14.02.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 25, datë 28.02.2020)

#### **d) makinat bujqësore.**

(Ndryshuar me udhëzim nr.18, dt. 23.8.2011, botuar ne Fl. Z. Nr. 120 dt. 24 gusht 2011).

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

dh) detyrimet e prapambetura, për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

Për këto mjete AAPSK-ja kryen procedurat e nevojshme për rihedhje në qarkullim apo shitje dhe detyrimi për taksën vjetore të mjeteve të përdorura lind në momentin e pajisjes së tyre me lejen e re të qarkullimit, pavarësisht se cili është pronari i tyre.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 8/1, dt. 17.5.2013, botuar ne Fl. Z. Nr. 89, dt. 27 maj 2013).

3.2 Përfshihen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkojnë nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

3.3.Përfshihen nga pagimi i taksës sëqarkullimit dhe taksës së karbonit anijet e peshkimit. Sasitë, kushtet dhe kriteret përcaktohenme vendim të Këshillit të Ministrave.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 27, dt.16.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.)

3.4 Përfshihen nga pagimi i taksës së përvitshme dhe të regjistrimit fillestar të mjeteve luksoze:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm një herë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë;

c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjete ka qenë i bllokuar, dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë; ç) të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze të sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për qëllime përdorimi apo rishitjeje. (Ndryshuar me Udhëzim Nr. 12 datë 04.04.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 10 prill 2017).

4. Të gjitha përjashtimet do të shënohen në një regjistër të veçantë, ku do të jetë shënuar emri, mbiemri, si dhe ekstremet e librezës sipas formularit nr.6, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4.2. Përjashtohen nga pagesa e taksës së materialeve/artikujve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi:

a) importimi për nevoja zyrtare dhe personale, në kuadër të misioneve iplomatike dhe konsullore, përfshirë edhe konsujt e nderit, si dhe misionet speciale të akredituara në Shqipëri;

b) importimi për nevoja zyrtare dhe personale të organizmave ndërkombëtarë, të njohur si të tillë nga Republika e Shqipërisë e sipas limiteve dhe kushteve të përcaktuara në konventat ndërkombëtare, në bazë të të cilave janë formuar këta organizma ose në marrëveshjet reciproke;

c) importimi i produkteve për qëllime të ndihmave humanitare;

ç) ambalazhet plastike të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, si më poshtë:

i) ~~arkat plastike;~~

ii) ~~fuçitë me kapacitet >=20 litra;~~

iii) ~~kapakët e CD-ve dhe DVD-ve;~~

iv) ~~kutitë paketuese dhe tasat për ushqime;~~

v) ~~kutitë e votimit;~~

vi) ~~mbajtëset për kafe, çaj, erëza;~~

vii) ~~mbajtëset për ushqimet, si: marmelatë, bukë, salcë, fruta, gjalpë, vaj etj.;~~

viii) ~~paketuesit për serumet, gjakun dhe barnat mjekësore;~~

d) ambalazhe qelqi, të importuara veçmas apo kur ambalazhojnë artikuj të tjerë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, si më poshtë:

i) ~~ampulat për barnat mjekësore;~~

ii) ~~shishet për mbajtjen e serumit, gjakut dhe barnave mjekësore;~~

dh) ambalazhet plastike dhe qelqi, të vendosura nën regjime doganore pezulluese.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt.16.1.2014, botuar në Fl. Z. Nr. 3, dt. 24 janar 2014).

5. Përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi, fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat në etiketën e miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kanë të evidentuar sasinë në përqindje të këtyre produkteve që janë trupëzuar në produktin

përfundimtar. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit sipas kësaj pike përcaktohen nga udhëzimi i përbashkët i ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për kontrollin ushqimor, referuar pikës 8, të nenit 9, të ligjit “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. (Shtuar me Udhëzimin nr.3, datë. 31.01. 2022, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 17. datë. 02.02.2022).

#### **4. Tarifat e shërbimit**

Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" nivelet e tarifave të shërbimit, për tarifën të cilat arkëtohen nga organet tatimore dhe doganore, do të përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, ndërsa tarifën të cilat mbledhen nga institucione të tjera, do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe titullarit të institucioneve respektive.

4.1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, statusin e invalidit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, statusin e veteranit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar, apo statusin e të verbërit, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, përjashtohen nga:

- a) tarifa për shërbimet konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona jashtë vendit;
- b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik;
- c) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e Kapitenerisë së Porteve;
- ç) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Personat e sipërpërmendur nuk i përfitojnë këto përjashtime nëse kryejnë veprimtari private si persona fizikë apo juridikë.

#### **5. Zbatimi i udhëzimit**

Ngarkohet me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, degët e tyre dhe agjentët përkatës.

(Ndryshuar me udhëzim nr.25, dt. 19.07. 2010, botuar ne Fl.Z. Nr. 94. dt. 22 korrik 2010).

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt.16.1.2014, botuar në Fl. Z. Nr. 3, dt. 24 janar 2014).

#### **6. Shfuqizime**

Udhëzimi nr.1, datë 30.1.2006 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", shfuqizohet.

#### **7. Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

